



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi i Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 01.10.2021, mori në shqyrtim praktikat e përgatitura nga drejtoritë teknike të ERE-s, dhe u shpreh si më poshtë:

1. Mbi miratimin e kërkesës për aplikim nga Gek Terna Grup, për fazën jo të detyrueshme në treg- testi i TAP AG, për kapacitetin dhe lidhjen e termocentralit me cikël të kombinuar me fuqi 160-180 MW në Roskovec, Fier.
2. Mbi përfundimin e procedurës administrative të nisur me vendimin e bordit të ERE-s nr. 185, datë 10.09.2021 “Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 11, seria PV03K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “Spahiu Gjanç” sh.p.k. me vendimin e bordit të ERE-s nr. 20, datë 19.12.2003” dhe përfundimin e procedurës administrative të nisur me vendimin e bordit të ERE-s nr. 186, datë 10.09.2021 “Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 224, seria T14P, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “Spahiu Gjanç” sh.p.k., me vendimin e bordit të ERE-s nr. 14, datë 03.03.2014”.
3. Për një ndryshim në vendimin e bordit të ERE nr. 187, datë 10.11.2017, “Për licencimin e shoqërisë Albgaz sh.a. në aktivitetin e shpërndarjes së gazit natyror”, i ndryshuar dhe një ndryshim në vendimin e bordit të ERE nr. 188, datë 10.11.2017, “Për licencimin e shoqërisë Albgaz sh.a. në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror”, i ndryshuar.